

LODHJA EMOCIONALE, VETEFIKASITETI DHE MOTIVIMI I NXËNËSVE SI SFIDË PËR  
MËSIMDHËNËSIT GJATË MËSIMIT ONLINE NË PERIUdhËN E PANDEMISË COVID-19

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTEVE NË PROGRAMIN PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

Nga:

FILONIDA KELMENDI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË MASTER

PRISHTINË

KORRIK, 2021

Lodhja Emocionale, Vetefikasiteti dhe Motivimi i Nxënësve si Sfidë për Mësimdhënësit gjatë  
Mësimet Online në periudhën e Pandemisë Covid-19

Nga:

Filonida Kelmendi

Mentor: Prof. Aliriza Arënliu

Qëllimi i këtij studimi është që të hulumtoj mbi lodhjen emocionale, vetefikasitetin dhe sfidën në motivimin e nxënësve tek mësimdhënësit në shkollat fillore në komunën e Prishtinës. Për të përshkruar marrëdhënien ndërmjet sfidave të përdorimit të teknologjisë dhe lodhjes emocionale e vetefikasitetit të mësimdhënësve është përdorur metoda sasiore. Instrument i përdorur është pyetësori i ndarë në tri seksione. Ky studim është korrelacional i cili është realizuar me N= 105 pjesëmarrës, prej tyre (N= 78 ose 73.6%) pjesëmarrës ishin femra, ndërsa (N= 27 ose 25.5%) pjesëmarrës ishin meshkuj. Pjesëmarrësit ishin prej niveleve të ndryshme të edukimit (N= 8 ose 7.5%) shkollën e lartë, (N= 58 ose 54.7%) nivelin bachelor, (N= 39 ose 36.8%) studimet master.

Ky studim përpiqet që të përgjigjet në pyetjet kërkimore që janë: sa sfidë ka qenë për mësimdhënësit mësimi online apo në distancë? A ka ndikuar mësimi online në lodhjen emocionale të mësimdhënësve? Sa ka pasur ndërlidhje sfida për mbajtjen e motivit të nxënësve me lodhjen emocionale tek mësimdhënësit? Nga pyetjet kërkimore janë ngritur dhe parashtruar dhe hipotezat e studimit, duke theksuar hipotezën që sa më e lartë ruajtja e vetefikasitetit nga ana e mësimdhënësve, aq më në nivel është bërë realizimi i procesit mësimor.

Pandemia si dukuri, pra përfshin përhapjen e një sëmundjeje në një dimension të gjerë gjeografik duke prekur kështu një përqindje jashtëzakonisht të lartë të popullatës (Filler, 2009). Situata e fundit e krijuar me pandeminë COVID-19 në masë të madhe ka ndryshuar rutinën e jetës

së individëve dhe mënyrën e funksionimit të përditshëm të shoqërisë në përgjithësi (Bërxulli & Arënlju, 2020). Situata e tillë pamundësojë mbarëvajtjen e procesit mësimor në objektet shkollore, por një proces i tillë u vendos që të realizohej përmes të mësuarit virtual apo online. Po ashtu, kërkesat për të zhvendosur mësimin në formatin online, është raportuar të kenë ndikuar gjithashtu në rritjen e nivelit të stresit dhe ankthit të mësimit në pjesë të ndryshme të botës (UNESCO, 2020). Sidoqoftë, në shoqëritë tjera në botë, përfshirë edhe Kosovën, të mësuarit në internet nuk është i zakonshëm dhe ka shumë çështje kur bëhet fjalë për zbatimin e kësaj mënyre të të mësuarit.

Andaj, studimi im do fokusohet në lodhjen emocionale, vetefikasitetin dhe motivimin e nxënësve si sfida kryesore për mësimit gjatë mësimit online në periudhën e pandemisë Covid-19. Duke pasur parasysh që edhe njohuria e mësimit për teknologjinë ka mundur të jetë faktorë për mbarëvajtjen gjatë mësimit online, dhe studimi synon t'a hulumtoj edhe këtë pikë.

Me qëllim të testimit të hipotezave është përdorur analiza e korrelacionit për të parë ndërlidhjen ndërmjet lodhjes emocionale, vetefikasitetit dhe sfidën në motivimin e nxënësve gjatë të mësuarit online. Rezultatet e raportuara treguan korrelacione të ndryshme ndërmjet këtyre variablave. Sfidat e përdorimit të teknologjisë kishin korrelacion më të fuqishëm me mungesën e ndërveprimit në klasë ( $r = .32, p = .01$ ), mirëpo sfidat e përdorimit të teknologjisë nuk treguan korrelacion me lodhjen emocionale të mësimit në klasë ( $r = .05, p = .61$ ). Ndërsa sfidat e përdorimit të teknologjisë treguan korrelacion të lartë me pozitivitetin profesional apo specifikisht me zhvillimin dhe avancimin gjatë karrieres ( $r = .29, p = .02$ ), njëkohësisht është treguar korrelacion i lartë ndërmjet sfidave të përdorimit të teknologjisë me vetefikasitetin e mësimit në klasë ( $r = .26, p = .07$ ). Mungesa e ndërveprimit me nxënës gjatë të mësuarit online ka ndikuar në lodhjen emocionale të mësimit në klasë duke treguar një korrelacion të lartë ( $r = .26, p = .05$ ). Lodhja emocionale ka treguar korrelacion negativ me pozitivitetin profesional ( $r = -.20, p = .41$ ). Poashtu

lodhja emocionale ka treguar korrelacion të fuqishëm me sfidat e motivimit të nxënësve në klasat virtuale ( $r = .36, p = .00$ ). Pozitiviteti profesional ka treguar korrelacion të lartë me vetefikasitetin e mësimit online. Periudha e pandemisë bashkë me natyrën e mësimit online kanë shfaqur një sfidë të konsiderueshme për mësimit online. Sfidat kryesore me të cilat janë përballur mësimit online gjatë mësimit online përfshijnë; pengesat teknike apo njohuritë mbi përdorimin e teknologjisë, po ashtu edhe mungesën e ndërveprimit e cila ka predikuar lodhjen emocionale dhe vetefikasitetin e mësimit online gjatë procesit mësimor përmes klasave virtuale.

ve ( $r = .50, p = .00$ ).

Sipas të gjeturave mësimit online kanë hasur vështirësi edhe në sfidën e motivimit të nxënësve duke përjetuar lodhje të theksuar emocionale. Mungesa e ndërveprimit me nxënës gjatë të mësimit online ka bërë të vështirë edhe procesin e mbajtjes së nxënësve të motivuar për mësim, duke shfaqur një lodhje të theksuar emocionale tek mësimit online. Kjo flet edhe për mungesën e ndërveprimit të drejtëpërdrejtë me nxënës, gjatë klasave virtuale. Sidoqoftë në kuadër të qasjeve të cilat aktualisht mësimit online kanë deklaruar të jenë duke i përdorur aktualisht përgjatë mësimit online, mungojnë elemente të interaksioneve me nxënës përmes të cilave vlerësohet angazhimi i tyre dhe pjesëmarrja aktive në kuadër të orëve mësimore (Hyseni- Duraku&Hoxha, 2020). Poashtu pozitiviteti profesional, sipas të gjeturave ka treguar edhe një ndërlidhje me vetefikasitetin e mësimit online duke treguar se mësimit online që ishin më entuziastë për avancim dhe përfitim të njohurive gjatë karrieres kishin më shumë vetefikasitet.

Duke u bazuar në gjetjet e studimit mbi sfidat e mësimit online gjatë mësimit online në periudhën e pandemisë Covid-19, një qasje rezultative për tërë institucionet arsimore specifiku për mësimit online, pastaj për nxënës si përfitues kryesor në këto ambiente është e nevojshme një ndërhyrje më e detajuar mbi faktorët pengues përgjatë procesit të mësimit online. Fillimisht

pjesa e studimeve sociale kërkon realizimin e hulumtimeve tjera mbi mësimdhënien dhe mësimin online duke pasur një qasje më të detajuar mbi format e ndryshme të realizimit të mësimin online ashtu edhe në klasë. Poashtu edhe një qasje të formave të përdorura për të mbajtur nxënësit e motivuar si në klasë fizike ashtu edhe gjatë mësimin online, kjo e realizuar edhe me metodën e intervistave gjysmë të strukturuar mbi mbledhjen e të dhënave.

Ndërsa situata evoluon, kërkohet patjetër një qasje më e qëllimshme, duke përfshirë përfaqësues nga fusha të shumta në vlerësimin dhe shkëmbimin e përvojave të tyre për atë që funksionoi mirë dhe çfarë jo. Duhet të marrë në konsideratë problemet dhe zgjidhjet me të cilat përballen nxënësit, prindërit dhe mësuesit. Të zhvillohen politika dhe programe shkollore, që t'i trajtojnë faktorët themelorë që ndikojnë në lodhjen emocionale të mësimdhënësve, dhe të ngriten mekanizma nga liderët e shkollave për monitorimin e zhvillimit të procesit mësimor.